

KONTRATE SHITJE
KUOTASH

Në Tiranë, sot me datë 24.08.2021 (dymijë e njëzetë e një), lidhet kjo Kontratë e Shitjes së një pjese të kuotës që Z. Artan Dulaku zotëron në Shoqërinë "Alba Beton" shpk. Kontrata lidhet ndërmjet palëve të mëposhtme.

1. Z. Artan Dulaku, i biri i Nikos, i datëlindjes 30.05.1965, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, në adresën Rruga "Pjetër Bogdani", Nr. 24/2, mbajtës i Letërnjoftimit ID Nr. 028592335 dhe Nr.personal G50530166T, madhor dhe me zotësi të plote juridike dhe per te vepruar, me cilësinë e **një prej ortakëve të Shoqërisë "Alba Beton" shpk, më poshtë identifikuar si SHITËSI.**

Dhe

2. Z. Erjon Harizi, i biri i Refatit, lindur më 19/10/1979, në Lumas, Berat, banues në Tiranë, në adresën Rruga "Tish Dahija", Kompleksi Kika, mbajtës i Letërnjoftimit ID Nr.027754398 dhe Nr. personal H91019106G, madhor dhe me zotësi të plote juridike dhe per te vepruar, me cilësinë e **një prej ortakëve të Shoqërisë "Alba Beton" shpk, më poshtë identifikuar si BLERËSI.**

Shitësi dhe Blerësi do të referohen së bashku si Palët.

KUSHTE PARAPRAKE

A. Shoqëria "Alba Beton" është Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIUS J62207004A, me seli qendrore në Petrele STERMAS, Njesia Administrative Petrelë, Tiranë. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 1.134.104.000 lekë (Një miliard e njëqind e tridhjetë e katër milion e njëqind e katër mijë), i përbërë nga 4 (katër) kuota kapitali. Kontributi i ortakëve në kapitalin e Shoqërisë është si më poshtë:

- Ortaku, z. Adrian Dulaku, është zotëruar i 1 (një) kuote, e cila përbën 29,7% (njëzet e nëntë pikë shtatë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë", ose në vlerë nominale 336'828'888 lekë.
- Ortaku, z. Artan Dulaku, është zotëruar i 1 (një) kuote, e cila përbën 30,6 % (tridhjetë pikë gjashtë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë", ose në vlerë nominale 347'035'824 lekë.
- Ortaku, z. Genci Dulaku, është zotëruar i 1 (një) kuote, e cila përbën 29,7 % (njëzet e nëntë pikë shtatë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë", ose në vlerë nominale 336'828'888 lekë.
- Ortaku z. Erion Harizi, është zotëruar i 1 (një) kuote, e cila përbën 10 % (dhjetë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë", ose në vlerë nominale 113'410'400 lekë.

B. Ortaku Artan Dulaku dëshiron t'i shesë ortakut Erjon Harizi 5% (pesë përqind) nga kuota e tij prej 30.6% dhe ky i fundit dëshiron të blejë këtë pjesë të kuotës së Ortakut Artan Dulaku, në përputhje me këtë Kontratë dhe vendimin e Asamblesë së Shoqërisë të marrë për këtë qëllim.

Cdo marrëveshje paraprake e arritur mes palëve pranohet dhe miratohet si pjesë e dispozitave vijuese. Si rezultat, Shitesi dhe Bleresi, bazuar në Statutin e Shoqërisë, Vendimin nr.7, datë 23.08.2021 të Shoqërisë dhe Ligjin nr. 9901, date 14.4.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, bien dakord si vijon:

Neni 1

Objekti i kontrates

Objekti i kesaj kontrate eshte shitblerja e 5% (pesë përqind) nga kuota me vlerë 30,6 % (tridhjetë pikë gjashtë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë "Alba Beton" (Shoqëria) shpk që Ortaku Artan Dulaku zotëron në këtë Shoqëri, në favor të Blerësit, në përputhje me këtë Kontratë dhe vendimin nr.7, datë 23.08.2021 të Asamblesë së Shoqërisë, bashkëlidhur kësaj Kontrate si pjesë integrale.

Neni 2

Garancite e ndërsjella

1. Shitesi garanton Bleresin se eshte pronar me te drejta te plota e të pakufizuara mbi objektin e kontratës dhe e zotëron te plote dhe te lire e pa asnje barre renduese gjithë përqindjen e tij takuese në Shoqëri.
2. Blerësi garanton Shitësin se, në përputhje me vendimin e asamblesë nr.7, datë 23.08.2021, nuk do të shesë kuotën e tij, pjesërisht apo tërësisht, brenda 5 viteve nga dita e nënshkrimit të kësaj Kontrate, por në çdo rast, jo përpara përfundimit të projektit në Palasë, Bashkia Himarë, përveç nëse ia shet kuotën e tij, me vlerën nominale, ortakëve ekzistues të Shoqërisë.
3. Blerësi pranon pa rezervë dhe garanton Shitësin dhe ortakët e tjerë të Shoqërisë për mostransferimin, e çfarëdo forme qoftë, të kuotës së tij, siç është përcaktuar në vendimin nr.7, datë 23.08.2021, të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë "Alba Beton" shpk, pikën 2 të këtij neni dhe nenin 5 të kësaj Kontrate.


Neni 3

Vlera e kontratës

1. Shitesi ka rene dakord t'ia shese Bleresit 5% (pesë përqind) te kuotës që Shitësi zotëron në Shoqëri me nje çmimin e tregut prej 6'000'000 (gjashtë milion) Leke dhe Bleresi shpreh dakordësinë pa rezervë për këtë vlerë.



2. Paga sa më sipër do të kryhet nga Blerësi brenda 30 ditësh nga dita e nënshkrimit të Kontratës dhe se Shitësi pranon regjistrimin e kësaj kontrate në QKB, duke u pasqyruar ndryshimi në përqindjen e kuotës të ortakët e Erjon Harizi dhe Artan Dulaku.



Neni 4

Transferimi i kuotave

1. Transferimi i kuotave do të behet duke ekzekutuar kontraten nepermjet regjistrimit të transferimit në regjistrin tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Regjistrimet kryhen në përputhje me afatet ligjore.
2. Palet konfirmojnë se pas ekzekutimit të kësaj kontrate dhe përfundimit të procedurave për kalimin e kuotave sipas kësaj kontrate, përqindjet takuese të ortakëve në Shoqëri janë:
 - Ortaku, z. Adrian Dulaku, është zotërues i 1 (një) kuote, e cila përbën 29,7% (njëzet e nëntë pikë shtatë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, ose në vlerë nominale 336,828,888 lekë.
 - Ortaku, z. Artan Dulaku, është zotërues i 1 (një) kuote, e cila përbën 25,6 % (njëzetë e pesë pikë gjashtë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, ose në vlerë nominale 290,330,624 lekë.
 - Ortaku, z. Genci Dulaku, është zotërues i 1 (një) kuote, e cila përbën 29,7 % (njëzet e nëntë pikë shtatë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, ose në vlerë nominale 336,828,888 lekë.
 - Ortaku z. Erjon Harizi, është zotërues i 1 (një) kuote, e cila përbën 15 % (pesëmbëdhjetë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, ose në vlerë nominale 170,115,600 lekë.

Neni 5

Kufizime në transferimin e kuotës së Blerësit

Ortaku Erjon Harizi kufizohet në shitjen/dhurimin dhe çfarëdo lloj forme tjetër transferimi, të përhershme apo të përkohshme, të kuotës së tij, për 5 vjet nga data e këtij vendimi, por, nëse Projekti i ndërtimit në Palasë, siç citohet në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë "Alba Beton" shpk nr.7, datë 23.08.2021, zgjat përtej këtij afati, ky kufizim shtrihet deri në përfundim të këtij Projekti dhe realizimit të qëllimit të Shoqërisë së Thjeshtë që do të krijohet për këtë Projekt. Përfundim nga ky kufizim bën rasti kur kuota e Ortakut Erjon Harizi i transferohet me vlerën e saj nominale të ortakëve ekzistues të Shoqërisë.

Vendimi nr.7, datë 23.08.2021 i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë "Alba Beton" shpk i bashkëlidhet kësaj kontrate dhe është pjesë integrale e saj.

Neni 6

Detyrime te Shitesit dhe Bleresit

1. Shitesi dhe Bleresi kane detyrimin qe te permbushin me rigorozitet kushtet e percaktuara ne kete Kontrate.
2. Palët përgjigjen përkatësisht për detyrimet fiskale qe mund te aplikohen per shkak te kalimit te kuotave, mbi secilin prej tyre.

Palet angazhohen qe te zgjidhin me mirekuptim te gjitha mosmarreveshjet qe lindin gjate permbushjes se kesaj kontrate. Ne rast te moszgjidhjes se mosmarreveshjeve me mirekuptim, palet kane te drejte ti drejtohen Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Kjo kontrate nenshkruhet ne 4 (kater) kopje origjinale ne gjuhen shqipe, me vlefshmeri te njejte. Palet e kesaj kontrate mbajne te pakten nga nje kopje origjinale te kontrates.

PALËT

BLERESI

Erjon HARIZI

Erjon Harizi
[Signature]

SHITESI

Artan DULAKU

Artan Dulaku
[Signature]

